



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:042036

Datë: 31.07.2023

Numri i dokumentit: 04536577

ARJ nr.103/2023

Gjykata Supreme në Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Ragip Namani kryetar, Nebojša Boričić dhe Beshir Islami anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses-propozueses, Komuna e Prishtinës, kundër të paditurës-kundër propozueses, Agjencia Kadastrale e Kosovës,(AKK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit të paditurës, me nr. 03/1122/22, të datës 28.12.2022, dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar nga paditësja, për mes përfaqësueses sipas autorizimit, Shoq. e Avokatëve, "Sejdiu & Qerkini", kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA nr.238/2023, të datës 12.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26 Korrik 2023, merr;

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e paditëses-propozueses, Komuna e Prishtinës, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA nr. 238/2023, të datës 12.04.2023.

Anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA. nr. 238/2023, të datës 12.04.2023. Mbetet në fuqi aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 327/2023, i datës, 14.03.2023.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA. nr. 238/2023, të datës 12.04.2023, në pikën I., të dispozitivit, Aprovohet e bazuar ankesa e të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), e datës 23.03.2023. Pika II., NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 327/2023, i datës, 14.03.2023. Pika III., REFUZOHET propozimi i paditësit-propozuesit Komuna e Prishtinës, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës me nr. 03/1122/22, i datës 28.12.2022.

Paditësi-propozuesi, Komuna e Prishtinës për mes përfaqësueses sipas autorizimit të cekur si më lartë, në Gjykatë Supreme në afat ligjor parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të

vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktvendimit të Gjykatës së Apelit, AA nr. 238/2023, të datës 12.04.2023, për shkak të; shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës nga nenin 182 par. 2 të LPK, me propozim që kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar, aktvendimi i atakuar i Gjykatës së Apelit AA nr. 238/2023, i dt. 12.04.2023, të anulohet ndërsa të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-departamenti për Çështje Administrative A nr. 327/2023, i datës 14.03.2023.

E paditura AKK, edhe pse nga shkresat e lëndës provohet se me datë 02.06.2023, e ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditëses, parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA. nr. 238/2023, të datës 12.04.2023, brenda fatit të lejuar ligjor nuk ka ushtruar përgjigje në kërkesë.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative në seancën e mbajtur pas vlerësimit të aktvendimit të goditur dhe atij të shkallës së parë, sipas pretendimeve në kërkesë dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e paditëses është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 327/2023, të datës, 14.03.2023, në pikën I., të dispozitivit, Aprovohet si i bazuar propozimi i paditësit/propozuesit, Komuna e Prishtinës dhe pika II., Shtyhet ekzekutimi i vendimit 03/1122/22 i dt. 28.12.2022 i të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës, deri sa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditëses.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë arsyeton ndër të tjera se, nga shqyrtimi i padisë dhe kërkesës së paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur si dhe shkresave të tjera të lëndës, si në kuptim të nenit 22 par.2 dhe 6 të LKA, vlerëson se paditësi ka ofruar prova të besueshme dhe ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në bazë të cilave vërtetohet se ekzekutimi i vendimit të paditurës AKK do ti sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej. Gjithashtu gjykata gjen se shtyrja e ekzekutimit të vendimit deri në vendosjen meritore është në interes publik e që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar. Se kjo do të shmangte pasojat e mundshme që do të shkaktoheshin në të ardhmen nëse vendimi i kundërshtuar i të paditurës në fund të procesit gjyqësor rezulton se është marrë në kundërshtim me ligjin. Andaj në këtë kuptim vlerëson se në këtë çështje janë plotësuar kushtet nga neni 22, par. 6, lidhur me par. 2, të LKA për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar deri në vendosjen përfundimtare të çështjes, dhe se ky vendim nuk paragjykon epilogun përfundimtar të këtij konflikti administrativ.

Gjykata së Apelit me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, AA nr. 238/2023, të datës 12.04.2023, duke vendosur në procedurë ankimore, e aprovon si të bazuar ankesën e të paditurës, Agjencia Kadatrale e Kosovës, duke vendosur decidivisht si në diapozitiv të aktvendimit të saj të cituar si në paragraf një të këtij aktvendimi.

Në arsyetim të vendimit të saj vlerëson se, nuk mund ti përkrahë si të rregullta dhe ligjore pikëpamjet juridike të shkallës së parë duke vlerësuar se i njëjti është i përfshirë me shkelje të thelbësore të LPK nga nenin 182 par.2 pika n) dhe nenin 183 .3, të cilët i citon dhe konkludon se, gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar fare ose e ka vlerësuar në mënyrë të gabuar

faktin se me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues paditësit-propozuesit mund ti shkaktohet dëm i pa riparueshëm e gjithashtu gabimisht e ka vlerësuar edhe faktin se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik. Andaj gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar drejtë propozimin për shtyrje për shkakun se paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë ose kushte të cilat janë të parapara me ligj sipas të cilave mundësohet shtyrja. Kolegji i Apelit vlerëson se nga kërkesa e paditësit dhe bazuar në pretendimet ankimore të paditurës mori vendimin e saj si në pikën III: me që me asnjë provë nuk janë plotësuar kushtet si përshihet nga nenin 22.2 të LKA ,sepse nga pretendimet në padi dhe kërkesë për shtyrje kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe të njëjtat nuk ndërliken me propozimin për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, andaj duke u bazuar në faktet si më lart dhe në kuptim të nenit 209, c), të LPK, vendos si në dispozitiv të vendimit të saj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes pas ekzaminimit të aktvendimit të atakuar me kërkesë, bazuar në pretendimet e palës paditëse-propozuese dhe shkresave të tjera të lëndës vlerëson se, nuk mund të aprovohet si i drejtë dhe ligjor qëndrimi juridik i Gjykatës së Apelit si në aktvendimin e saj. Sipas vlerësimit të kolegjit, arsyetimi i aktvendimit të kontestuar është i mangët dhe jo bindës mbi faktet vendimtare, në drejtim të dëmit i cili vështirë do të riparohet para se të vlerësohet ligjshmëria e aktit të kontestuar të paditurës në procedurë të rregullt gjyqësore, që shtyrja nuk do të ishte në dëm të palës kundërshtare apo palës së interesuar dhe nëse nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik ashtu si parashihet me nenin 22 të LKA. Nga kjo rezulton se arsyetimi i aktvendimit kontestues të Gjykatës së Apelit nuk përmban arsye të justifikueshme sipas akteve të lëndës dhe objektit të saj me refuzimin e propozimit të paditëses për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur të AKK. Nuk janë të qëndrueshme theksimet në arsyetim të aktvendimit të Gjykatës së Apelit se.” *Aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelle të dispozitave të LPK nga nenin 182.par.2 pika n), dhe nenin 183 vërtetim i gabuar i gjendjes faktike*”, të cilët i citon, sepse nuk argumentohet në arsyetim, me konstatime dhe fakte vendimtare në përputhje me çështjen në shqyrtim, dispozitave të cilat i citon dhe provave në shkresa të lëndës, se cilat janë provat dhe faktet që kanë rezultuar me refuzimin e kërkesës së paditëses për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur por vetëm në mënyrë deklarative theksohet se, gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar faktet përkatësisht i ka vërtetuar në mënyrë të gabuar se me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, paditësit i shkaktohet dëm i pa riparueshëm.

Prandaj aktvendimi i Gjykatës së Apelit rezulton jo i drejtë dhe ligjor sipas çështjes në shqyrtim, çështje pronësore e cila objekt shqyrtimi në procedurë gjyqësore ka vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të AKK me të cilin paditësi obligohet të bëjë ekzekutimin e Aktvendimit me nr. 3173 të dt. 07.05.1970, për njohje të drejtës pronësore në paluajtshmëri palës ankuese. Masën e përkohshme e bënë kontestuese dhe diskutabile edhe fakti se sipas aktvendimit të Gjykatës së shkallës së parë A nr. 327/23 të dt. 02.05.2023, duke vendosur në ri procedurë sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna në aktvendimin e Gjykatës së Apelit, nr. AA nr. 238/2023 të dt. 12.04.2023, (e cila kishte aprovuar ankesën e palës ankuese N. B. me të cilën kishte kërkuar ti njihet e drejta e palës me interes në këtë lëndë), shkalla e parë ia njeh statusin e palës me interes dhe i lejonet qasja në shkresa të lëndës. Nga kjo rezulton se situata bëhet edhe më e pa qartë lidhur me të drejtën pronësore të palëve, andaj është imediate dhe me interes që vendimi i organit të paditur, i AKK të shtyhet gjer sa të vlerësohet ligjshmëria e tij në procedurë gjyqësore me vendim përfundimtar gjyqësor dhe të definohet e drejta pronësore në paluajtshmërinë kontestuese në sipërfaqe prej 13ha,18ar, 88m2.

Nga gjendja e konstatuar si më lartë sipas pretendimeve në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, padi dhe provave të tjera të paraqitura, kolegji i Gjykatës Supreme vlerëson se me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur dhe regjistrimin e pronës lëndore në emër të palës B. V. si pronar juridik, gjer sa prona evidentohet në emër të Komunës së Prishtinës, para se të vlerësohet ligjshmëria e tij në procedurë të rregullt, sipas argumenteve të palëve ndërgjyqëse dhe bazave ligjore, ekziston dyshimi i bazuar se mund të shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohej, ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA ,për paditësin si dhe palët me interes, me që statusi i pronës lëndore mund të ndryshoj deri sa të vendoset çështja kryesore e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të AKK. Kolegji po ashtu vlerëson se nuk provohet me asnjë provë që shtyrja është në kundërshtim me interesin publik, përkundrazi është e justifikueshme dhe në interes të përgjithshëm dhe publik shtyrja e ekzekutimit të aktvendimit të organit të paditur, nr. 03/1122/22 të dt. 28.12.2022, me të cilën paditësi është obliguar që të bëjë ekzekutimin e Aktvendimit me nr. 3173 të dt. 07.05.1970, për mos të arritur në situatë që sido që të vendoset çështja kryesore sipas padisë,(dhe nëse eventualisht pa paragjykim), nëse në procedurë gjyqësore do të rezultonte se vendimi i organit të paditur është jo ligjor pasojat do të rezultonin vështirë të riparueshme. Kolegji po ashtu vlerëson se edhe pse e paditura AKK ka nxjerrë vendim përfundimtar në procedurë administrative për deri sa të vlerësohet ligjshmëria e tij në procedurë të rregullt gjyqësore, nuk provohet se të këtij organi i shkaktohet dëm i cili vështirë do të riparohej, pa u krijuar kushtet ligjore për implementimin e tij të kontestuar në procedurë gjyqësore.

Nga theksimet si më lartë dhe në pajtim me nenin 54, paragrafi 1 dhe 2, lidhur me nenin 22 par. 2 dhe 6, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME –PRISHTINË
ARJ nr.103/2023, me datë 26 Korrik 2023.

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani